

## PYETJET PËR EDUKATËN QYTETARE

### Pyetja 1

Nga pikëpamja kronologjike më parë është përpunuar koncepti i demokracisë:

- A) Politike
- B) Industriale
- C) Ekonomike
- D) Apo janë përpunuar njëkohësisht

### Pyetja 2

Demokracia përfaqësuese është karakteristikë:

- A) Për polisët e lashta greke
- B) Për qytet-shtetin e Romës
- C) Për shtetet në monarkinë e kastave
- D) Për shtetet bashkëkohore

### Pyetja 3

Demokracia e drejtpërdrejtë karakterizonte më shumë qytetërimin e lashtë, sepse:

- A) Nuk kishte lindur dhe nuk ishin zhvilluar ende format e realizimit të demokracisë
- B) Këto institucione ekzistonin, por njerëzit nuk i parapëlqenin
- C) Forma të tjera ishin joefektive për atë shkallë qytetërimi
- D) Asnjëra prej tyre

### Pyetja 4

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Demokracia e drejtpërdrejtë është forma më efikase e realizimit demokracisë
- B) Demokracia parlamentare dhe demokracia përfaqësuese nuk kanë asnjë lidhje me njëra-tjetrin
- C) Sistemi përpjesëtimor ka më shumë përparësi se sistemi mazhoritar
- D) Edhe A dhe B

Pyetja 5

E ka përkufizuar demokracinë si "qeverisje të të varfërve":

- A) Perikliu
- B) Aristoteli
- C) Tit Livi
- D) Justiniani

Pyetja 6

Demokracia referendare është:

- A) Ushtrimi i drejtpërdrejtë i pushtetit të popullit në të gjitha çështjet e organizimit dhe veprimtarisë së shoqërisë
- B) Ushtrimi i pushtetit të popullit nëpërmjet përfaqësuesve të tij në organet dhe institucionet e zgjedhura prej tij
- C) Mënyra e zgjedhjes së organeve përfaqësuesve të popullit që do të ushtrojnë më pas pushtetin e tij
- D) Të tria së bashku

Pyetja 7

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Demokracia karakterizon marrëdhëniet politike në një vend të caktuar
- B) Demokracia shpreh mënyrën karakteristikat e sistemit politik të shoqërisë
- C) Demokracia shpreh mënyrën e qeverisjes
- D) Të tria së bashku

Pyetja 8

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Demokracia ushtrohet përmes pjesëmarrjes së popullit në qeverisje
- B) Demokracia përfaqëson mbrojtjen e interesave të shumicës
- C) Demokracia nënkupton barazinë ekonomike e politike të qytetarëve
- D) Demokracia ekziston vetëm në Republikë

Pyetja 9

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Demokracia do të thotë qeverisje nëpërmjet debatit, kontradiktave dhe konkurrencës
- B) Demokracia e vërtetë është demokracia përfaqësuese
- C) Demokracia ushtrohet vetëm me referendum
- D) Demokracia ekziston vetëm në formë elektronike

Pyetja 10

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Demokracia elektorale realizohet përmes referendumeve
- B) Demokracia referendare është shprehje e demokracisë së drejtpërdrejtë
- C) Demokracia elektorale ushtrohet nëpërmjet zgjedhjeve të rregullta
- D) Dy prej tyre

Pyetja 11

Perikliu i Athinës së lashtë e ka përkufizuar demokracinë:

- A) "Si qeverisje e të varfërve"
- B) "Si qeverisje e shumicës së popullit"
- C) "Si qeverisje në dobi të shumicës"
- D) "Si qeverisje nëpërmjet debatit"

Pyetja 12

Format që i ngjasojnë demokracisë së drejtpërdrejtë është:

- A) Iniciativa popullore
- B) Referendumi
- C) Plebishti
- D) Apo të tria format së bashku

Pyetja 13

Referendumi i detyrueshëm është forma e:

- A) Deklarimit të zgjedhësve në të cilën akti i cili është objekt referendumi nuk miratohet, por vetëm merret mendimi i qytetarëve lidhur me të
- B) Shpalljes kur e kërkon numri i caktuar i zgjedhësve, numri i deputetëve në Parlament, etj.
- C) Deklarimit të drejtpërdrejtë e një numri të caktuar të zgjedhësve që t'i propozojnë organit përfaqësues nxjerrjen e një akti të caktuar juridik
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 14

Referendumi konsultativ është:

- A) Formë e deklaramit të drejtpërdrejtë, e cila nënkupton deklaramin e një numri të caktuar të zgjedhësve që t'i propozojnë organit përfaqësues nxjerrjen e një akti të caktuar juridik
- B) Formë e deklaramit të zgjedhësve në të cilën akti i cili është objekt referendumi nuk miratohet, por vetëm merret mendimi i qytetarëve lidhur me të
- C) Formë e deklaramit të zgjedhësve i cilin për çështje të caktuara duhet medoemos nga se kështu është parashikuar me kushtetutë apo me ligj
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 15

Objekt i të vendosurit me referendumi duhet të jenë çështjet me:

- A) Karakter të kombëtar
- B) Karakter ndërkombëtar
- C) Të dyja së bashku
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 16

Ajo që e dallon referendumin nga plebishti është:

- A) Forma e deklaramit të zgjedhësve i cilin për çështje të caktuara të parashikuar me kushtetutë apo me ligj
- B) Objekti për të cilin duhet të deklarohen zgjedhësit
- C) Formë e deklaramit të zgjedhësve në të cilën akti i cili është objekt referendumi nuk miratohet, por vetëm merret mendimi i qytetarëve lidhur me të
- D) Të tria së bashku

Pyetja 17

Iniciativa popullore është:

- A) Formë e deklaramit të drejtpërdrejtë, e cila nënkupton deklaramin e një numri të caktuar të zgjedhësve që t'i propozojnë organit përfaqësues nxjerrjen e një akti të caktuar juridik
- B) Formë e deklaramit të zgjedhësve në të cilën akti i cili është objekt referendumi nuk miratohet, por vetëm merret mendimi i qytetarëve lidhur me të
- C) Formë e deklaramit të zgjedhësve i cilin për çështje të caktuara duhet të jenë objekt vetëm për çështje me karakter ndërkombëtar
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 18

Plebishti është një formë deklarimi për çështjet si:

- A) Deklarimi për vetvedosjen e një populli si e drejtë kolektive e tij
- B) Shpallja e pavarësisë
- C) Shkëputjen nga një shtet
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 19

Sistemi mazhoritar i zgjedhjeve ushtrohet:

- A) Përmes konkurrimit me dy raunde
- B) Përmes konkurrimit të kandidatëve në zonat njëemërore
- C) Përmes konkurrimit edhe me një raund
- D) Të tria së bashku

Pyetja 20

Sistemi përpjesëtimor i zgjedhjeve ushtrohet:

- A) Përmes votimit me dy raunde
- B) Përmes konkurrimit të partive si subjekte elektorale
- C) Përmes sistemit të shumicës absolute për kandidatin
- D) Apo ndonjë alternativ tjetër

Pyetja 21

Sistemi mazhoritar dhe përpjesëtimor i zgjedhjeve:

- A) Përjashtojnë kategorikisht njëri-tjetrin
- B) Mund të kombinohen me njëri-tjetrin
- C) Mund të zbatohen pavarësisht njëri nga tjetri
- D) Edhe B edhe C

Pyetja 22

Në sistemin zgjedhor mazhoritar është karakteristikë:

- A) Paraqitja e kandidatit për të cilën votohet
- B) Paraqitja e listës për të cilën votohet
- C) Partia fituese përfaqësohet në Parlament me kandidatët që kanë fituar drejtpërdrejtë
- D) Dy prej tyre

Pyetja 23

Në sistemin zgjedhor përpjesëtimor:

- A) Veprohet parimi "fituesi merr gjithçka"
- B) Partitë politike marrin vendet në parlament në përputhje me votat që fitojnë në shkallë vendi
- C) Fiton kandidati që ka marrë më shumë se 50% të votave
- D) Fiton kandidati që ka marrë shumicën e thjeshtë të votave

Pyetja 24

Konsensusi për çështje të caktuara të zhvillimit të vendit është karakteristik për:

- A) Sistemin paraindustrial
- B) Sistemin politik anglo-amerikan
- C) Sistemin politik evropiano-kontinental
- D) Sistemin politik totalitar

Pyetja 25

Bllokimi i plotë i iniciativës dhe i ekonomisë private është karakteristikë:

- A) Sistemin totalitar fashist
- B) Sistemin totalitar komunist
- C) Për të dy
- D) Për asnjërin prej tyre

Pyetja 26

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Diktatura fashiste vendosen në vende të prapambetura ekonomikisht
- B) Një pushtet presidencial i fortë është tipar i një shteti jo demokratik
- C) Në shoqërinë demokratike nuk ka më rrezik për totalitarizëm
- D) Dy prej tyre

Pyetja 27

Pushteti shtetëror i marrë në mënyrë të përgjithshme paraqet unitetin e:

- A) Pushtetit legjislativ i përfaqësuar nga parlamenti, i miraton ligjet
- B) Pushtetit ekzekutiv i përfaqësuar nga qeveria dhe presidenti, administrojnë dhe zbatojnë ligjet
- C) Pushtetit gjyqësor, i përfaqësuar nga gjykatat interpreton ligjet dhe i zgjidh në kontestet
- D) Apo me të tria pushtetet së bashku

Pyetja 28

Me pushtet shtetëror nënkuptojmë një procedurë mjaft komplekse të punës së shtetit që ka të bëjë me:

- A) Nxjerrjen e ligjeve
- B) Marrjen e vendimeve
- C) Sigurimin e zbatimit të ligjeve dhe vendimeve në mënyrë të[ drejtpërdrejtë dhe të detyrueshme
- D) Të tria së bashku

Pyetja 29

Parimi i ndarjes së pushteteve:

- A) Shpreh pavarësinë dhe ndarjen absolute midis pushteteve
- B) Është një parim kushtetues
- C) Përjashton marrëdhëniet midis pushteteve
- D) Të tria së bashku

Pyetja 30

Gjeni pohimin e pasaktë:

- A) Qeverisja e bazuar në doktrinën e ndarjes së pushteteve ka më pak mundësi të zbatojë parimet e shtetit të së drejtës
- B) Qeverisja e bazuar në doktrinën e ndarjes së pushteteve e parandalon keqpërdorimin e pushteteve dhe ka më pak mundësi të jetë autoritare
- C) Ndarja e pushteteve nuk e pengon një degë të pushtetit të influencoi apo të dominojë mbi degët e tjera apo të imponoi vullnetin e vet mbi publikun e gjerë

Pyetja 31

Brenda pushtetit legjislativ dallohen:

- A) Funksionet kushtetutvënës
- B) Funksioni i rregullt legjislativ
- C) Funksionet normativ, i cili ushtrohet përmes akteve administrative
- D) Apo të tria funksionet së bashku

Pyetja 32

Qeveria si organ ekzekutiv në shtetet parlamentare formohen dhe mbikëqyren:

- A) Presidenti
- B) Kryeministri
- C) Parlamenti
- D) Apo të tria së bashku

Pyetja 33

Gjeni pohimin e pasaktë:

- A) Kushtetuta është ligji më i lartë i shtetit
- B) Kushtetuta sanksionon të drejtat dhe liritë e qytetare
- C) Kushtetuta vendos parimin e pandashmërisë së të drejtave themelore
- D) Kushtetuta vendos parimin e moskufizimit të të drejtave themelore

Pyetja 34

Kushtetuta si akt themelor i shtetit është karakteristike:

- A) Për shtetet antike
- B) Për të gjitha shtetet demokratike
- C) Për shtetet evropiane
- D) Për shtetet moderne

Pyetja 35

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

- A) Të gjitha ligjet nuk mund të vijnë në kundërshtim me kushtetutën
- B) Është akti më i lartë dhe themelor i shtetit me fuqi më të lartë juridike
- C) Është një deklaratë politike
- D) Edhe a edhe b

Pyetja 36

Kushtetuta e sotme e Republikës së Shqipërisë është miratuar:

- A) Në vitin 1991
- B) Në vitin 1994
- C) Në vitin 1998
- D) Në vitin 1999



Pyetja 37

Kushtetuta e sotme e Republikës së Shqipërisë është miratuar:

- A) Nga Asambleja Kushtetuese
- B) Nga Kuvendi i Shqipërisë
- C) Nga referendumi popullor
- D) Dy prej tyre

Pyetja 38

Në kuptimin formal Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

- A) Konsiston në përmbajtjen e kushtetutës dhe në esencën shoqërore të saj, e cila nënkupton një tërësi rregullash themelore me të cilën rregullohet baza e rendit shoqëror, shtetëror e juridik të një vendi
- B) Është akti më i lartë juridik i shkruar dhe i kodifikuar, me fuqi më të lartë juridike, i miratuar nga organi më i lartë shtetëror sipas një procedure të veçantë
- C) Të dyja së bashku
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 39

Në kuptimin material Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

- A) Është akti më i lartë juridik i shkruar dhe i kodifikuar, me fuqi më të lartë juridike, i miratuar nga organi më i lartë shtetëror sipas një procedure të veçantë
- B) Konsiston në përmbajtjen e kushtetutës dhe në esencën shoqërore të saj, e cila nënkupton një tërësi rregullash themelore me të cilën rregullohet baza e rendit shoqëror, shtetëror e juridik të një vendi
- C) Të dyja së bashku
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 40

Format e miratimit të Kushtetutës të bazuara në parimin e sovranitetit të popullit është:

- A) Miratimi nga ana e organit kushtetutvënës
- B) Miratimi nga ana e organit të zakonshëm legjislativ
- C) Miratimi me referendum
- D) Miratimi i kombinuar (një herë nga parlamenti e pastaj me referendum)
- E) Të gjitha format e miratimit së bashku

Pyetja 41

Aktet me të cilat bëhen ndryshimi apo plotësimi i Kushtetutës janë:

- A) Amendamentet
- B) Ligji kushtetues
- C) A dhe B së bashku
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 42

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

- A) Është organi më i lartë i pushtetit legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor
- B) Ushtron funksionin politik
- C) Ushtron funksionin ekzekutiv
- D) Të tria së bashku

Pyetja 43

Gjeni pohimin e pasaktë:

- A) Deputetët përfaqësojnë popullin dhe lidhen me mandat detyrues
- B) Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj
- C) Deputetët mund të kryejnë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, por mos të fitoj pasuri të këtyre
- D) Mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga parlamenti

Pyetja 44

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Kryeministri zgjidhet nga Kuvendi
- B) Kryeministri caktohet nga partia fituese
- C) Kryeministri caktohet nga konsultimet e presidentit të Republikës me partinë fituese
- D) Kryeministri caktohet nga Qeveria

Pyetja 45

Në bazë të Kushtetutës, forma e qeverisjes në Shqipëri është:

- A) Monarki parlamentare
- B) Shtet unitar i decentralizuar
- C) Republikë parlamentare
- D) Republikë parlamentaro-presidenciale

Pyetja 46

Shteti si organizim politik të shoqërisë ka si veçori themelore:

- A) Territorin
- B) Popullsi
- C) Sovraniteti
- D) Të tria së bashku

Pyetja 47

Sovraniteti i pushtetit shtetëror në një shoqëri demokratike buron nga:

- A) Proceset e vendimmarrjes për rregullimin e të gjitha raporteve shoqërore në shtetin demokratik
- B) Vullneti i lirë i votuesve
- C) Respektimi i ligjeve dhe e legjitimon atë
- D) Të tria së bashku

Pyetja 48

Pushteti i një organizate mund të kufizohet nga:

- A) Mënyra se si roli i saj kuptohet dhe interpretohet prej shoqërisë
- B) Mënyra se si roli i saj kuptohet dhe interpretohet prej shoqërisë
- C) Në të dyja
- D) Apo të gjithë faktorët së bashku

Pyetja 49

Organizata, parti ose grupe shoqërore përpiqen të sigurojnë dhe ushtrojnë pushtet politik nëpërmjet:

- A) Veprimeve të planifikuara e të studiuara
- B) Të ardhurave e mjeteve të tjera pasurore
- C) Përdorimit të potencialeve dhe aftësive intelektuale
- D) Spekulimeve dhe mashtrimeve të opinionit publik

Pyetja 50

Pavarësia e pushteteve ka parasysh:

- A) Kontrollin e ndërsjellët të veprimtarisë së tyre
- B) Ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre
- C) Edhe A edhe B
- D) As A dhe as B

Pyetja 51

Presidenti është njëkohësisht kryetar i qeverisë në:

- E) Republikën parlamentare
- F) Republikën Presidenciale
- G) Në të dyja
- H) Asnjërën prej tyre

Pyetja 52

Gjeni pohimin e saktë:

- I) Presidenti Republikës së Shqipërisë është edhe kryetari Qeverisë
- J) Presidenti Republikës së Shqipërisë është kryetari i shtetit shqiptarë
- K) Presidenti Republikës së Shqipërisë zgjidhet drejtpërdrejt nga populli
- L) A dhe B së bashku

Pyetja 53

Shpallja e ligjeve të miratuara në Shqipëri është kompetencë e:

- A) Presidentit të Republikës
- B) Parlamentit
- C) Kryeministrit
- D) Apo e ndonjë organi tjetër

Pyetja 54

Është kompetencë e Presidentit të Republikës së Shqipërisë:

- A) Miratimi i ligjeve
- B) Shpallja e ligjeve
- C) Komanda e Përgjithshme e Forcave të Armatosura të RSH
- D) A dhe B së bashku

Pyetja 55

Gjeni pohimin e pasaktë:

- A) Presidenti i Republikës së Shqipërisë shpall ligjin e miratuar brenda 15 ditëve nga paraqitja e tij
- B) Presidenti i republikës së Shqipërisë ka të drejtë ta kthej ligjin për shqyrtim vetëm një herë
- C) Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humb fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit
- D) Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 20 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare

Pyetja 56

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Gjykata Kushtetuese gjykon çështjet penale
- B) Gjykata Kushtetuese kontrollon kushtetutshmërinë e ligjeve
- C) Gjykata Kushtetuese nxjerr ligje të reja
- D) Të tria pohimet e mësipërme

Pyetja 57

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Në drejtimin e shoqërisë së sotme ndeshen të gjitha format e autoritetit politik
- B) Pushteti është aftësia për të kontrolluar veprimet e të tjerëve, pavarësisht nga dëshirat e tyre
- C) Pushteti i vërtetë i një organizate ose grupi shoqëror është atë i fuqishëm sa është i pafuqishëm pushteti i organizatës ose grupit shoqëror opozitar me të
- D) Edhe A edhe B

Pyetja 58

Regjimet fashiste janë:

- A) Sisteme politike të tipit paraindustrial
- B) Sisteme politike totalitare
- C) Sisteme politike të tipi evropian
- D) Pushtete politike të tipit totalitar

Pyetja 59

Sistemet politike totalitare karakterizohet:

- A) Nga ekonomia e tregut
- B) Nga pluralizmi politik
- C) Nga pluralizmi ideologjik
- D) Nga ekzistenca e një ideologjie zyrtare

Pyetja 60

Në Shqipëri, pushteti gjyqësor ushtrohet nga:

- A) Presidenti i republikës dhe gjykatat
- B) Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe gjykatat e tjera, të cilat krijohen me ligj
- C) Gjykata Kushtetuese
- D) Gjykata e lartë dhe gjykatat e tjera të shkallëve më të ulta

Pyetja 61

Është funksion i pushtetit gjyqësor:

- A) Gjykimi i ligjeve
- B) Gjykimi i konflikteve midis palëve
- C) Dënimin e veprave në kundërshtim me interesat e shoqërisë
- D) Dy prej tyre

Pyetja 62

Parlamentet e krijuara në Mesjetë dallon për:

- A) Pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të popullit
- B) Pjesëmarrja e përfaqësuesve të zgjedhur
- C) Pjesëmarrja e shtresave më të larta të shoqërisë
- D) Pjesëmarrja e shtresave më të fshatarëve të mesëm

Pyetja 63

Përfaqësues i Kuvendit në marrëdhëniet e tij të brendshme e të jashtme është:

- A) Kryetarët e grupeve parlamentare
- B) Kryetari i Kuvendit
- C) Byroja parlamentare
- D) Kryetarët e komisioneve parlamentare

Pyetja 64

Janë organizime të brendshme të Kuvendit:

- A) Zyra e financës
- B) Komisionet parlamentare
- C) Administrata dhe zyrat e brendshme të Kuvendit
- D) Juristët e Kuvendit

Pyetja 65

Grupet parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë:

- A) Janë organizime të Kuvendit për kontrollin ndaj Qeverisë
- B) Janë organizime të formuara sipas përkatësisë partiake
- C) Janë organizime të Kuvendit sipas fushave të caktuar të veprimtarisë
- D) Janë organizime të seancës plenare

Pyetja 66

Kuvendi ushtron funksionin ligjvënës:

- A) Kur i jep votëbesimin qeverisë
- B) Kur miraton rezoluta për politikën e jashtme
- C) Kur miraton kodet
- D) Në tria rastet e mësipërme

Pyetja 67

Kuvendi ushtron funksionin politik:

- A) Kur miraton kodet
- B) Kur miraton ligjet
- C) Kur përcakton qëndrimin e vendit për çështje të caktuara
- D) Alternativet A dhe B

Pyetja 68

E drejta e qeverisë për të propozuar ligjet shpreh:

- A) Funksionin e saj ekzekutiv
- B) Funksionin e saj administrativ
- C) Marrëdhënie e qeverisë me pushtetin ligjvënës
- D) Funksionin legjislativ të qeverisë

Pyetja 69

Kur miraton aderimin e vendit në organizatat ndërkombëtare:

- A) Kuvendi ushtron funksionin politik
- B) Kuvendi ushtron funksionin administrativ
- C) Kuvendi ushtron funksionin ligjvënës
- D) Kuvendi ushtron funksionin diplomatik

Pyetja 70

Presidenti i Republikës së Shqipërisë:

- A) Është komandant i forcave të armatosura të RSH
- B) Emëron dhe shkarkon të gjithë gjyqtarët e RSH
- C) Të dyja së bashku
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 71

Partitë politike kanë synim kryesor:

- A) Ushtrimin e veprimtarive sociale
- B) Marrjen dhe ushtrimin e pushtetit politik
- C) Ushtrimin e presionit mbi qeverisjen e vendit
- D) Ushtrimin e veprimtarive zgjedhore

Pyetja 72

Gjykimi i çështjes në shkallë të dytë bëhet:

- A) Nga Gjykata Kushtetuese
- B) Nga Gjykata e Rrethit
- C) Nga Gjykata e Apelit
- D) Nga Gjykata Lartë

Pyetja 73

Partitë politike në sistemin politik evropian:

- A) Janë parti politike elektorale
- B) Kanë programe dhe alternative të ndryshme nga njëra-tjetrit
- C) Kanë në thelb marrëveshjen midis tyre
- D) Nuk kanë një disiplinë të fortë ndaj anëtarëve të tyre



Pyetja 74

Partitë politike të tipit amerikan:

- A) Janë parti politike elektorale
- B) Lejohet krijimi i vetëm dy partive
- C) Është karakteristike dypartizimi
- D) Janë të vërteta dy prej alternativave të mësipërme

Pyetja 75

Një parti politike që aspirojnë për zgjidhjen e çështjeve të mbarë kombit, mund të jenë parti:

- A) Të djathta
- B) Të qendrës
- C) Të majta
- D) Të tre tipave së bashku

Pyetja 76

Një parti politike e ushtron pushtetin e vet nëpërmjet:

- A) Ndikimit që ka në popull
- B) Autoritetit të saj
- C) Njerëzve që zgjedh në organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv
- D) Përfaqësuesve të vet në organin gjyqësor

Pyetja 77

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Partitë politike të tipit evropian kanë karakter më të theksuar ideologjik se partitë politike tipit amerikan
- B) Roli i partive të vogla politike ose i partive rajonale është në çdo kohë i papërfillshëm për zhvillimin e shoqërisë
- C) Partitë politike të krahut të majtë mbrojnë interesat e shtresave të larta të shoqërisë
- D) Asnjëherë veprimtaria politike e partive nuk bie ndesh me interesat e shoqërisë

Pyetja 78

Gjeni pohimin e saktë. Organet e administratës shtetërore mund të krijohen:

- E) Qysh në Kushtetutë
- F) Jo vetëm nga Kushtetuta por edhe me ligj
- G) Jo vetëm sa më sipër, por edhe nga Këshilli i Ministrave
- H) Apo ndonjë alternativë tjetër

Pyetja 79

Organet e administratës shtetërore klasifikohen në organe individuale:

- A) Sipas mënyrës së financimit
- B) Sipas shtrirjes tokësore
- C) Sipas strukturës organizative dhe mënyrës së marrjes së vendimeve
- D) Sipas mënyrës së krijimi të tyre

Pyetja 80

Janë organe kolegjiale:

- A) Këshilli i Ministrave
- B) Ministritë
- C) Kryetari i Bashkisë
- D) Bashkia

Pyetja 81

Janë organe buxhetore:

- A) Organet që financohen nga Banka e Shqipërisë
- B) Organet që financohen nga shteti
- C) Organet që financohen nga Ministria e Financave
- D) Organet që vetëfinancohen

Pyetja 82

Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka detyrë kushtetuese:

- A) Të konsultohet me partinë fituese për emërimin e Kryeministrit
- B) T'i japë votëbesimin qeverisë
- C) Të jap mocionin e besimit ndaj kryetarit të qeverisë
- D) Të kryesojë Këshillin e Ministrave

Pyetja 83

Është funksioni kryesor i qeverisë:

- A) Funksioni ligjvënës
- B) Funksioni ekzekutiv
- C) Funksioni administrativ
- D) Edhe a edhe b

Pyetja 85

Aktet nënligjore të qeverisë janë:

- A) Ligjet
- B) Aktet për miratimin e buxhetit të shtetit
- C) Aktet për propozimin e projektligjeve
- D) Vendimet dhe udhëzimet

Pyetja 86

Cilat organe marrin pjesë në krijimin e qeverisë?

- A) Presidenti Republikës
- B) Gjykata Kushtetuese
- C) Këshilli i Lartë i Drejtësisë
- D) Dy prej tyre

Pyetja 87

Si e kontrollon Kuvendi veprimtarinë e Qeverisë?

- A) Nëpërmjet komisioneve hetimore
- B) Përmes interpelancave
- C) Përmes ligjeve
- D) Edhe a edhe b

Pyetja 88

Ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të administratës qendrore:

- A) Krijohen me vendim të këshillit Ministrave
- B) Janë të gjithë anëtar të Këshillit të Ministrave
- C) Janë të gjithë organe kolegjiale
- D) Vetëm ministrat janë anëtarë të Këshillit të Ministrave

Pyetja 89

Përfaqëson njësi bazë të Qeverisjes vendore:

- A) Komuna
- B) Qarku
- C) Bashkia
- D) Edhe a edhe c

Pyetja 90

Qarku në qeverisjen vendore:

- A) Është njësi bazë e qeverisjes
- B) Është njësi më e vogël, e përbërjes e qeverisjes
- C) Është njësi më e madhe, e përbërjes e qeverisjes
- D) Është njësi që lidh pushtetin qendror me atë vendor

Pyetja 91

Këshilli i Komunës në qeverisjen vendore:

- A) Emërohet nga Këshilli i Ministrave
- B) Zgjidhet nga Kuvendi
- C) Zgjidhet nga Këshilli i Bashkisë
- D) Zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë nga populli

Pyetja 92

Cili është parimi kushtetues kryesor që zbatohet në qeverisjen vendore:

- A) Parimi i ndarjes së pushteteve
- B) Parimi i iniciativës së lirë ekonomike
- C) Parimi prezumimit të pafajësisë
- D) Parimi i vetëqeverisjes dhe autonomisë

Pyetja 93

Këshilli i Komunës dhe i Bashkisë në qeverisjen vendore:

- A) Zgjidhet nga Kuvendi me votim të hapur
- B) Zgjidhet nga Kuvendi me votim të fshehtë
- C) Zgjidhet me votim të drejtpërdrejt nga populli
- D) Zgjidhet me votim të jo të drejtpërdrejt nga populli

Pyetja 94

Këshilli i Qarkut në qeverisjen vendore:

- A) Zgjidhet me votim të drejtpërdrejt nga populli
- B) Zgjidhet nga Kuvendi
- C) Përbëhet nga anëtarët të deleguar nga bashkitë dhe komunat
- D) Apo ndonjë mënyrë tjetër

Pyetja 95

Organet e njësisve të Qeverisjes vendore nxjerrin:

- A) Ligje
- B) Akte këshillimore
- C) Akte për vënien në zbatim të akteve të Këshillit të Ministrave
- D) Urdhëresa, vendime dhe urdhëra

Pyetja 96

Prefektura përfaqëson në qeverisjen vendore:

- A) Njësinë e Qarkut
- B) Njësinë bazë të qeverisjes vendore
- C) Këshillin administrativ të Qarkut
- D) Apo ndonjë alternativë tjetër

Pyetja 97

Elementët bazë për krijimin e shtetit janë:

- A) Organizimi i popullsisë në bazë të lidhjes nga gjaku
- B) Organizimi i popullsisë në bazë të territorit
- C) Organizimi i popullsisë sipas kufijve shtetërorë
- D) Të tria alternativet e mësipërme

Pyetja 98

Në njësitë e qeverisjes vendore:

- A) Prefektura është njësi vendore e pandashme
- B) Bashkia është e ndarë në disa komuna
- C) Bashkia ndahet në disa qarqe
- D) Mund të krijohen edhe minibashkitë

Pyetja 99

Prefekti përfaqëson:

- A) Është organ që zgjidhet nga populli
- B) Organi më të rëndësishëm të Këshillit të Qarkut
- C) Përfaqësues i qeverisë në planin lokal
- D) Është organ që zgjidhet nga Kryeministri

Pyetja 100

Ministrat:

- A) Janë organe qendrore individuale
- B) Janë njësi administrative dhe organizative
- C) Nxjerrin urdhëra dhe udhëzime
- D) Dy prej tyre

Pyetja 101

Është i vërtet pohimi:

- A) Prefekti mund të kontrollojë ligjshmërinë e akteve të pushtetit vendor
- B) Prefekti mund të rrëzoj aktet e paligjshme të pushtetit vendor
- C) Prefekti mund t'i kërkojë gjykatës shqyrtimin e akteve të pushtetit vendor
- D) Dy prej tyre

Pyetja 102

Ministrat në Republikën e Shqipërisë, emërohen në detyrë dhe shkarkohen nga:

- A) Nga Kolegjiumi i ministrisë
- B) Nga Kryeministri
- C) Nga Presidenti i Republikës me propozim të Kuvendit
- D) Nga Presidenti i Republikës me propozim të Kryeministrit

Pyetja 103

Dypartizimi në sistemin politik përfaqëson:

- A) Ndalimin e ardhjes në pushtet të partive të tjera
- B) Alternimin e dy partive në pushtet
- C) Mungesën e pluralizmit politik
- D) Ndalimin e krijimit të partive të tjera

Pyetja 104

Dypartizimi është karakteristikë për:

- A) Sistemin politik anglo-amerikan
- B) Sistemin politik evropiano-kontinental
- C) Sistemin politik të republikave parlamentare
- D) Sistemin politik të republikave federale

Pyetja 105

Zgjedhja e Kryetarit të Shtetit me votim popullor është karakteristikë:

- A) Për formën parlamentare të qeverisjes
- B) Për formën presidenciale të qeverisjes
- C) Për formën gjysëmpresidenciale të qeverisjes
- D) Dy prej alternativet të mësipërme

Pyetja 106

Kryetari i Shtetit ushtron edhe pushtetin ekzekutiv:

- A) Në sistemin politik anglo-amerikan
- B) Në republikat presidenciale
- C) Në republikat parlamentare
- D) Dy nga alternativet e mësipërme

Pyetja 107

Sistemet politike ku shteti ka kontroll absolut mbi organizimin e shoqërisë, mjetet e komunikimit, jetën ekonomike, kulturore etj., njihen si sistem politikë:

- A) Demokratike
- B) Teokratike
- C) Liberale
- D) Totalitare

Pyetja 108

Karakteristikë për republikat parlamentare është:

- A) Zgjedhja e Presidentit të Republikës nga populli
- B) Zgjedhja e Presidentit të Republikës nga Parlamenti
- C) Zgjedhja e Presidentit të Republikës nga "Asambleja e Zgjedhësve"
- D) Emërimi i Presidentit nga Qeveria

Pyetja 109

Në kuadrin e parimit të ndarjes së pushteteve, mund të pohojmë se pushteti ekzekutiv jep llogari për veprimtarinë e tij në:

- A) Gjykatën Kushtetuese
- B) Parlamenti
- C) Presidenti
- D) Qeveria

Pyetja 110

Veto parlamentare ka të bëjë me:

- A) Delegimin e pushtetit legjislativ nga Parlamenti te Qeveria
- B) Anulimin e vendimeve të Parlamentit nga organet e tjera më të ulëta të pushtetit legjislativ
- C) Anulimin e vendimeve të organeve më të ulëta të pushtetit legjislativ
- D) Mos dekretimin e ligjeve të miratuar nga Presidenti i Republikës

Pyetja 111

Këshilli i Lartë i Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, është organi që ka si kompetencë:

- A) Kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve
- B) Shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të dhëna nga Gjykatat e shkallëve më të ulëta
- C) Emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve në Gjykatës Kushtetuese
- D) Emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve në përgjithësi

Pyetja 112

Kryetari i Qeverisë në Republikën e Shqipërisë, emërohet nga:

- A) Parlamenti
- B) Presidenti
- C) Kryetari partisë ose koalicionit që ka fituar shumicën në zgjedhjet fundit
- D) Kryetari i Parlamentit

Pyetja 113

Ndarja administrative-tokësore e Republikës së Shqipërisë bëhet nga:

- A) Presidenti
- B) Kryeministri
- C) Këshilli i Ministrave
- D) Apo asnjëra prej tyre



Pyetja 114

Këshillat e Bashkive në Republikën e Shqipërisë, zgjidhen për një periudhë:

- A) 2 vjet
- B) 3 vjet
- C) 4 vjet
- D) 5vjet

Pyetja 115

Kryetari Komunës ose Bashkisë në Republikën e Shqipërisë, kur kryejnë akte që vijnë në kundërshtim me Kushtetutën ose kryejnë shkelje të rënda të ligjit, mund të shkarkohen nga:

- A) Parlamenti
- B) Presidenti me propozim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave
- C) Prefekti
- D) Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

Pyetja 116

Këshilli i Qarkut në Republikën e Shqipërisë, zgjidhet për një periudhë:

- A) 2 vjet
- B) 3 vjet
- C) 4 vjet
- D) 5vjet

Pyetja 117

Këshilli i Qarkut në Republikën e Shqipërisë, përbehet nga anëtarë që:

- A) Zgjidhen nga populli
- B) Zgjidhen nga Parlamenti
- C) Emërohet nga Parlamenti
- D) Delegohet nga baskitë dhe komunat përkatëse

Pyetja 118

Gjeni pohimin e pasaktë:

- A) Prefekti përfaqëson Qeverinë në planin lokal
- B) Prefekti emërohet nga Parlamenti
- C) Prefekti emërohet nga Këshilli i Ministrave
- D) Mbikëqyr ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga organet e pushtetit lokal

Pyetja 119

Prefekti në Republikën e Shqipërisë, nxjerr akte që quhen:

- A) Udhëzime
- B) Urdhëresa
- C) Ligje
- D) Edhe A edhe B

Pyetja 120

Rretho pohimin e pasaktë: Prefekti në Republikën e Shqipërisë:

- A) Siguron mbrojtjen e interesave shtetërore
- B) Mbikëqyr ligjshmërinë e akteve që nxirren nga organet e pushtetit lokal
- C) Përgjigjet para Këshillit të Ministrave për gjendjen e përgjithshme të prefekturës
- D) Përgjigjet para Gjykatës së Lartë për gjendjen e përgjithshme të prefekturës

Pyetja 121

Kur mund të realizohet një ndarje re administrative në formë rrethi:

- A) Kur ka të paktën 10 000 banorë
- B) Kur ka të paktën 25 000 banorë
- C) Kur ka një pasuri të mjaftueshme për të qenë rreth më vete
- D) Edhe B edhe C

---

## I. TË DREJTAT E NJERIUT

Pyetja 122

Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut:

- A) Është hartuar nga Komisioni i të Drejtave të Njeriut
- B) Është miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara
- C) Është hartuar e miratuar nga Këshilli i Evropës
- D) Edhe A edhe B

Pyetja 123

E drejta e Njeriut për të jetuar:

- A) Është e drejtë kushtetuese me karakter vetjak
- B) Është e drejtë ligjore
- C) Është e drejtë kushtetuese me karakter politik
- D) Edhe a edhe c

Pyetja 124

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është:

- A) Akti më i rëndësishëm kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut
- B) Akti më i rëndësishëm evropian në këtë fushë
- C) Instrumenti i parë tërësorë i të drejtave të njeriut, që ka nxjerrë një organizatë ndërkombëtare universale, siç është OKB-ja
- D) Miratuar në vitin 1950

Pyetja 125

Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Evropiane e të Drejtave të Njeriut:

- A) Në vitin 1994
- B) Në vitin 1995
- C) Në vitin 1996
- D) Në vitin 1999

Pyetja 126

Liria e ndërgjegjes dhe e fesë përfaqëson:

- A) Liri kulturore
- B) Liri vetjake kushtetuese
- C) Është e papajtueshme me ateizmin
- D) Edhe a edhe b

Pyetja 127

E drejta për arsim:

- A) Përcaktohet si e drejtë vetjake
- B) Mund ta ushtrojnë vetëm qytetarët që kanë mbushur moshën 18 vjeç
- C) Është një e drejtë detyrë
- D) Është vetëm një e drejtë publike

Pyetja 128

Liria e shprehjes:

- A) Garantohet nga Kushtetuta
- B) Është një liri e pakufishme
- C) Është një e drejtë sociale
- D) Është një e drejtë kulturore

Pyetja 129

Projekti i parë i Komunitetit Evropian përfaqësohet nga:

- A) Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike (EUROATOM)
- B) Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut (CECA)
- C) Traktati i Romës për formimin e Gjykatës Ndërkombëtare
- D) Traktati i Mاستrihtit

Pyetja 130

Këshilli i Evropës përfaqëson:

- A) Organizatë ndërkombëtare me karakter universal
- B) Një nga qendrat që bashkërendon përpjekjet e një numri të madh shtetesh për të vendosur demokracinë dhe për të respektuar të drejtat e njeriut
- C) Një organ të Këshillit të Sigurimit
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 131

Organi që siguron respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është:

- A) Parlamenti Evropian
- B) Gjykata e Hagës
- C) Këshilli i Kujdestarisë së të Drejtave të Njeriut
- D) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Pyetja 132

Këshilli i Sigurimit është:

- A) Organizatë Ndërkombëtare me karakter rajonal
- B) Organizatë Ndërkombëtare me karakter universal
- C) Organi kryesor në strukturën e OKB-ës
- D) Organi kryesor në strukturën e OSBE-së

Pyetja 133

Organi legjislativ i Bashkimit Evropian është:

- A) Asambleja Parlamentare
- B) Parlamenti Evropian
- C) Komisioni Evropian
- D) Këshilli i Sigurimit

Pyetja 134

Mbrojtja e të drejtave të Njeriut përbën objektivin kryesor të organizatës si më poshtë:

- A) Parlamenti Evropian
- B) Këshilli i Evropës
- C) Këshilli Ministror
- D) NATO

Pyetja 135

Krijimi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara u mbështet:

- A) Në vendimin për vazhdimin e punës së Lidhjes së Kombeve, më 1946
- B) Në hartimin e Aktit final të Helsinkit
- C) Në hartimin e Kartës së OKB-së
- D) Edhe a edhe c

Pyetja 136

Organizata e Kombeve të Bashkuara përfaqëson:

- A) Organizatën rajonale për sigurimin e shtetit ligjor
- B) Organizatë universale për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare
- C) Organizatën rajonale për sigurimin e bashkëpunimit në Evropë
- D) Aleancë ushtarake për mbrojtjen e pakicave kombëtare

Pyetja 137

Ishin shtete iniciatorë për krijimin e OKB-së:

- A) Fuqitë e Mëdha të Koalicionit Antifashist
- B) Bashkimi Sovjetik
- C) Irlanda
- D) Greqia

Pyetja 139

Organizata e Kombeve të Bashkuara:

- A) Mban vetëm qëndrime morale ndaj shteteve
- B) Nuk ndërhyt në asnjë rast
- C) Kundërvepron kundër çdo akti të agresionit
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 140

Deklarata e të Drejtave të Fëmijëve:

- A) Është hartuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 1949
- B) Është hartuar nga Këshilli i Evropës
- C) Është deklaratë me karakter rajonal
- D) Është deklaratë me karakter universale

Pyetja 141

Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) dallohet për anëtarësinë e saj për:

- A) Trajtimin global të sigurimit
- B) Instrumentet e parandalimit të konflikteve
- C) Praktikën tanimë të konsoliduar të dialogut dhe konsensusit midis shteteve pjesëtare
- D) Të tria së bashku

Pyetja 142

Britania e Madhe:

- A) Është iniciatorë e gjashtëshes së parë për formimin e Komunitetit Evropian
- B) Është anëtare e nëntëshes në Komunitetin Evropian
- C) Pranimi i saj, u kundërshtua nga Franca
- D) Dy prej tyre

Pyetja 143

Organet kryesore të Komunitetit Evropian janë:

- A) Komisioni i Komisioni i Komunitetit Evropian
- B) Parlamenti Evropian
- C) Këshilli i Ministrave
- D) Gjykatat
- E) Apo të gjitha organet së bashku

Pyetja 144

Shqipëria është anëtare e OKB-ës:

- A) Prej vitit 1945
- B) Prej vitit 1955
- C) Prej vitit 1965
- D) Prej vitit 1975

Pyetja 145

Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës:

- A) Prej vitit 1994
- B) Prej vitit 1995
- C) Prej vitit 1996
- D) Prej vitit 1999

### ***EDUKATE PJESA E DYTE***

Pyetja 1

Rregullat dhe ligjet në demokraci :

- A) Hartohen për të përmbushur intereset e grupeve më të pasura të shoqërisë;
- B) Hartohen sipas vullnetit dhe dëshirës të kryetarit të shtetit;
- C) Janë të pandryshueshme;
- D) Ndryshojnë duke zbatuar të drejtën e individit për vendimmarrje.

Pyetja 2

Traditat dhe zakonet:

- A) Janë rregulla sjelljeje të pandryshueshme;
- B) Janë rregulla sjelljeje të detyrueshme për të gjithë shtetasit;
- C) Shërbejnë si rregulla sjelljeje në grupe më të vogla shoqërore;
- D) Rregulla penguese për veprimtarinë e individëve në shoqëri.

Pyetja 3

Presidenti i Republikës së Shqipërisë :

- A) Zgjidhet drejtpërdrejt nga populli;
- B) Emërohet nga Partia që fiton zgjedhjet;
- C) Zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë;
- D) Zgjidhet çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 18 vjeç.

Pyetja 4

Shqipëria është:

- A) Republikë parlamentare;
- B) Republikë gjysëmparlamentare;
- C) Republikë presidenciale;
- D) Monarki Parlamentare.

Pyetja 5

Forma më e përhapur e martesës në shoqërinë e sotme shqiptare është:

- A) Monogamia seriale;
- B) Monogamia;
- C) Poliandria;
- D) Poligjinia.

Pyetja 6

Drejtimi i shtetit me dorë të forte nga një njeri është tipar karakteristik për:

- A) Monarkinë parlamentare;
- B) Monarkinë kushtetuese;
- C) Republikën presidenciale;
- D) Sistemin totalitar.

Pyetja 7

Monarku në Monarkinë kushtetuese:

- A) Ushtron pushtet të pakufizuar;
- B) Harton dhe miraton ligjet;
- C) Ushtron pushtet të kufizuar;
- D) Gjykon mbi çështje të ndryshme.



Pyetja 8

Në Republikën e Shqipërisë pushteti gjyqësor ushtrohet nga:

- A) Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë;
- B) Ministria e drejtësisë;
- C) Kuvendi i Shqipërisë;
- D) Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Pyetja 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor është kompetencë:

- A) E Kuvendit të Shqipërisë;
- B) E Gjykatës kushtetuese;
- C) E Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- D) E Avokatit të Popullit.

Pyetja 10

Në Republikën e Shqipërisë organi më i lartë ligjvënës është:

- A) Gjykata Kushtetuese;
- B) Gjykata e Lartë;
- C) Kuvendi;
- D) Institucioni i presidentit.

Pyetja 11

Zgjidhja përfundimtare e ankesave të shtetasëve për zbatimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore është kompetencë:

- A) E Komitetit Shqiptar të Helsinkit;
- B) E Gjykatës Kushtetuese;
- C) E Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- D) E Avokatit të Popullit.

Pyetja 12

Hartimi, diskutimi dhe miratimi i ligjeve është kompetencë:

- A) E Gjykatës Kushtetuese;
- B) E Gjykatës së Lartë;

- C) E presidentit;
- D) E Kuvendit.

Pyetja 13

Në Republikën e Shqipërisë pushteti ekzekutiv realizohet:

- A) Nga organet qendrore dhe vendore;
- B) Vetëm nga organet qendrore;
- C) Nga presidenti;
- D) Nga Kuvendi.

Pyetja 14

Lidhja e Kombeve u formua për:

- A) Kufizimin ushtarak të shteteve të mëdha;
- B) Sigurimin dhe ruajtjen e tërësisë tokësore;
- C) Si kundërpeshë ndaj këshillit të Europës;
- D) Si kundërpeshë ndaj Bashkimit Europian.

Pyetja 15

Në qershor 1945 në San Francisko u themelua :

- A) Organizata e Kombeve të Bashkuara;
- B) Bashkimi Europian;
- C) NATO
- D) Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Europian.

Pyetja 16

Dokumenti: Deklarata për parimet e marrëdhënie të ndërsjellta, për forcimin e besimit, sigurisë e çarmatimit u miratua nga:

- A) OKB-ja;
- B) Keshilli i Evropës;
- C) Parlamenti Evropian;
- D) KSBE-ja.

Pyetja 17

Të drejtat civile janë:

- A) Mosdiskriminimi.

- B) Minimumi jetik.
- C) Përfshirja në punë publike.
- D) Të ardhura të mjaftueshme.

Pyetja 18

Të drejtat politike janë:

- A) Votimi.
- B) Të ardhura të mjaftueshme.
- C) E drejta për banim
- D) E drejta për arsim.

Pyetja 19

Të drejtat ekonomike janë

- A) Mbledhjet
- B) Mbrojtja nga shteti
- C) E drejta për punë
- D) Lëvizja e lirë.

Pyetja 20

Të drejtat sociale janë:

- A) Krijimi i sindikatave.
- B) Identiteti kulturor.
- C) Ushtrimi i zgjedhjeve.
- D) Ushtrimi i traditave.

Pyetja 21

Një ndër Organizmat e O.K.B është:

- A) Komiteti i të drejtave të njeriut.
- B) Komiteti për të drejtat e fëmijëve.
- C) Organizata botërore e ushqimit dhe bujqësisë.
- D) UNICEF

Pyetja 22

Një ndër agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara është:

- A) Organizata ndërkombëtare e punës.

- B) Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj grave.
- C) Fondi për viktimat e torturës.
- D) PNUD

Pyetja 23

Ç'përfaqsonte pushteti i faraonit:

- A) Ishte përfaqësuesi më i lartë i klerit;
- B) Ishte gjykatës suprem;
- C) Ishte komandant i ushtrisë
- D) Të tria së bashku.

Pyetja 24

Kodi i Hamurabit synonte:

- A) Forcimin e shtetit;
- B) Vendosjen e marrëdhënive me shtetasit;
- C) Përcaktimin e detyrimeve të shtetasve;
- D) Të tria së bashku.

Pyetja 25

Sundimi oligarkik është sundimi:

- A) I një personi;
- B) I një grupi personash;
- C) I popullsisë së lirë;
- D) I klasës skllavopronare.

Pyetja 26

Parlamenti lindi

- A) Në Angli;
- B) Në SHBA;
- C) Në Itali;
- D) Në Greqi.

Pyetja 27

Karta e Madhe e Lirive në Angli shpalli:

- A) Forcimin e pushtetit mbretëror;
- B) Kufizimin e pushtetit mbretëror;
- C) Ndarjen e kishës nga shteti;
- D) Ndarjen e pushtetit.

Pyetja 28

Lindja e krishterimit ishte:

- A) Sajesë e filozofëve remake të lidhur me pushtetin;
- B) Rezultati i imponimit të perandorëve romakë;
- C) Rezultat i rrethanave ekonomike dhe shoqërore;
- D) Të tria së bashku.

Pyetja 29

Në vitin 1949 disa shtete të Europës Perëndimore themeluan në Londër:

- A) OKB-në;
- B) NATO;
- C) Këshillin e Europës;
- D) Tregun e Përbashkët European.

Pyetja 30

Organizata e Sigurimit dhe e Bashkëpunimit European (OSBE) u themelua:

- A) Në Bruksel më 1949;
- B) Në Romë më 1957;
- C) Në Berlin më 1972;
- D) Në Helsinki më 1975.

Pyetja 31

Disa vende të Europës Perëndimore dhe SHBA krijuan në prill 1949:

- A) Paktin Ushtarak të Atlantikut të Veriut;
- B) Bashkimin European;
- C) Organizatën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin European;
- D) Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Pyetja 32

Plani Marshall u hartua për të ndihmuar:

- A) Azinë;
- B) Amerikën Latine;
- C) Europën;
- D) Afrikën.

Pyetja 33

Të jesh anëtar i një komuniteti duhet:

- A) Të jeni miq;
- B) Të pëlqeni njeri-tjetrin;
- C) Të keni shije të ngjashme;
- D) Të jesh pjesë e diçkaje më të madhe se vetja.

Pyetja 34

Të jesh pjesë e një grupi duhet:

- A) Të kesh diçka të përbashkët me të tjerët në grup, një karakteristikë, interes etj;
- B) Të mos marrësh pjesë në grupe të tjera;
- C) Të kesh vetëm përfitime dhe asnjë përgjegjësi;
- D) Të mos jeni të ndërvarur nga njeri-tjetri.

Pyetja 35

Të ndërtosh një komunitet duhet:

- A) Të kesh tradita dhe zakone të njejta;
- B) Të kesh njohje dhe lidhje miqsore të mëparshme;
- C) Të shohësh vlera dhe partneritet te të tjerat;
- D) Të mos marrësh pjesë në komunitete të tjera.

Pyetja 36

Gjeni përgjigjen e saktë:

- A) Demokracia nënkupton barazinë ekonomike e politike të qytetarëve;
- B) Demokracia ushtrohet përmes pjesëmarrjes së popullit në qeverisje;
- C) Demokracia përfaqëson vetëm mbrojtjen e interesave të shumicës;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 37

Në shoqërinë demokratike çdo individ gëzon:

- A) Të drejtën e lirisë, barazisë dhe drejtësisë;
- B) Të drejtën të thotë lirisht fjalën e tij e ta mbrojë atë;
- C) Të drejtën të marrë pjesë edhe në marrjen e vendimeve;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 38

Në shoqërinë demokratike:

- A) Vendimi i shumicës është gjithmonë i drejtë;
- B) Ka edhe raste kur shumica nuk ka të drejtë për vendimin që merr;
- C) Vendimi i shumicës nuk gjykohet në asnjë rast, por është i detyrueshëm të zbatohet;
- D) Asnjëra prej tyre.

Pyetja 39

Gjeni përgjigjen e saktë:

- A) Sistemi politik është tërsia e institucioneve, grupeve të interesit;
- B) Sistemi politik është i përbërë nga anëtarë të organizatave sociale që kanë pushtetin;
- C) Sistemet politike dallohen ndërmjet tyre nga mënyra evçantë e ushtrimit të pushtetit politik;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 40

Agjencia e specializuar e Kombeve të Bashkuara është:

- A) Organizata Botërore e Ushqimit dhe bujqësisë;
- B) UNHCR;
- C) PNUD;
- D) UNICEF.

Pyetja 41

Agjencia e specializuar e Kombeve të Bashkuara është:

- A) UNIFEM
- B) UNFPA;

- C) Organizata Botërore e Shëndetësisë;
- D) UNEP.

Pyetja 42

Meknizëm i zbatimit të Kombeve të Bashkuara është:

- A) FAO;
- B) ILO;
- C) Komiteti kundër torturës;
- D) Instituti për trajtim dhe kërkim.

Pyetja 43

21 Shkurti është:

- A) Dita botërore e meteorologjisë;
- B) Dita botërore e shëndetit;
- C) Dita botërore e ujit;
- D) E gjuhës amtare.

Pyetja 44

21 Shtatori është:

- A) Dita ndërkombëtare e paqes;
- B) Dita botërore e banimit;
- C) Dita botërore e mësuesit;
- D) Dita botërore e detit.

Pyetja 45

9 Tetori është:

- A) Dita botërore e ushqimit;
- B) Dita botërore e postës;
- C) Dita ndërkombëtare e rinisë.
- D) Dita botërore pa duhan.



Pyetja 46

10 Dhjetori është:

- A) Dita e aviacionit civil ndërkombëtar;
- B) Dita e të drejtave të njeriut;
- C) Dita ndërkombëtare e emigracionit;
- D) Dita ndërkombëtare kundër SIDES

Pyetja 47

Qarko pohimin e saktë:

- A) Indentiteti i një individi formësohet përmes ndërveprimit me familjen e vet;
- B) Disa pjesë të indentitetit të një individi janë të lindura;
- C) Disa pjesë të indentitetit të një individi janë të mësuara;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 48

Qarko pohimin e saktë:

- A) Ndryshimi përreth nesh është sasior dhe cilësor;
- B) Ndryshimi është vetëm pozitiv;
- C) Ndryshimi prek vetëm individitet dhe jo kombet.
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 49

Qarko pohimin e saktë:

- A) Ndryshimi përreth nesh është sasior dhe cilësor;
- B) Ndryshimi është pozitiv dhe negativ;
- C) Ndryshimi prek individitet dhe kombet.
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 50

Në shoqërinë bashkëkohore nënkulturat kryesore përcaktohen nga:

- A) Klasat shoqërore;
- B) Përkatësia etnike;
- C) Profesionet;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 51

Termi “Simboli kulturor” tregon:

- A) Diçka që përçon një kuptim të caktuar;
- B) Një marrëdhënie mes njerzëve;
- C) Kriteria vlerësimi;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 52

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Simbolet kulturore nuk ndryshojnë në rrjedhën e kohës;
- B) Simbolet kulturore kanë kuptim të njejtë për të gjitha kulturat;
- C) Kultura të ndryshme kanë simbole të veçanta;
- D) Asnjëra prej tyre.

Pyetja 53

Anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit janë:

- A) SHBA, Anglia, Franca, Rusia, Gjermania;
- B) SHBA, Anglia, Franca, Rusia, Kina;
- C) SHBA, Anglia, Rusia, Gjermania, Japonia, Kanadaja;
- D) SHBA, Anglia, Franca, Italia, Kina.

Pyetja 54

Paprekshmëria e personit, të drejtat dhe liritë e njeriut për herë të parë u shpallën në dokumentin:

- A) “E Drejta Romake”;
- B) “E Drejta Salike”;
- C) “Karta e Madhe e Lirive”;
- D) “Kodi i Justinianit”.

Pyetja 55

Numri i anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit është:

- A) Pesë;
- B) Shtatë;
- C) Njëmbëdhjetë;
- D) Pesëmbëdhjetë.

Pyetja 56

Sindikatat janë organizata me karakter:

- A) Politik;
- B) Ekonomik;
- C) Kulturor;
- D) Sportiv.

Pyetja 57

KSBE njihet e tillë deri në vitin:

- A) 1994;
- B) 1975;
- C) 1981;
- D) 1990

Pyetja 58

Lidhja e Kombeve është krijuar më:

- A) 1989;
- B) 1919;
- C) 1995;
- D) 2001

Pyetja 59

Sa shtet e kanë njohur dhe nënshkruar Deklaratën e OKB-së deri më 1945:

- A) 30 shtete;
- B) 42 shtete;
- C) 51 shtete;
- D) 10 shtete.

Pyetja 60

Sa shtet e kanë njohur dhe nënshkruar Deklaratën e OKB-së deri më 1950:

- A) 51 shtet
- B) 40 shtete
- C) 54 shtete
- D) 60 shtete

Pyetja 61

Kur u pranua Shqipëria anëtare e OKB-së:

- A) 1945;
- B) 1950;
- C) 1955;
- D) 1960.

Pyetja 62

Kur u pranua Shqipëria anëtare e Lidhjes së Kombeve:

- A) 1919;
- B) 1920;
- C) 1923;
- D) 1925.

Pyetja 63

Konventa për të drejtat e fëmijëve ka hyrë në fuqi:

- A) 1980;
- B) 1990;
- C) 1992;
- D) 1995.

Pyetja 64

Konventa për të drejtat e fëmijëve përmban:

- A) 54 nene;
- B) 32 nene;
- C) 45 nene;
- D) 47 nene.

Pyetja 65

Kur e ratifikoi Shqipëria Konventën për të drejtat e fëmijëve:

- A) 1992;
- B) 1997;
- C) 1999;
- D) 2000.

Pyetja 66

Në fund të vitit 1999 Konventën për të drejtat e fëmijëve është ratifikuar nga:

- A) 190 shtete;
- B) 191 shtete;
- C) 194 shtete;
- D) 90 shtete.

Pyetja 67

Deklarata Universale e të drejtave të njeriut u shpall nga Kombet e Bashkuara më:

- A) 1945;
- B) 1948;
- C) 1950;
- D) 1960.

Pyetja 68

Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore është shpallur:

- A) 1966;
- B) 1960;
- C) 1945;
- D) 1948.

Pyetja 69

Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike është krijuar më:

- A) 1950;
- B) 1955;
- C) 1966;
- D) 1960.

Pyetja 70

Karta e Kombeve të Bashkuara në vitin 1945 është miratuar nga:

- A) 45 shtete;
- B) 50 shtete;
- C) 54 shtete;
- D) 56 shtete.

Pyetja 71

Magna Karta në Angli u hartua më:

- A) 1210;
- B) 1215;
- C) 1250;
- D) 19270.

Pyetja 72

Deklarata Amerikane e Pavarësisë është hartuar më:

- A) 1770;
- B) 1776;
- C) 1778;
- D) 1790.

Pyetja 73

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ndodhet në :

- A) Londër;
- B) Vjenë;
- C) Paris,
- D) Strasburg

Pyetja 74

Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut u krijua në:

- A) Uashington;
- B) Paris;
- C) Strasburg;
- D) Moskë.

Pyetja 75

Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut u miratua më:

- A) 1969;
- B) 1980;
- C) 1985;
- D) 1999.

Pyetja 76

Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut u miratua më:

- A) 1972;
- B) 1980;
- C) 1981;
- D) 1987.

Pyetja 77

Deklarata për një mjedis dhe zhvillim e Rio de Zhanejro është miratuar më :

- A) 1992;
- B) 1995;
- C) 2001;
- D) 2005.

Pyetja 78

Deklarata e Konferencës së Kombeve të Bashkuara të Mjedisit të Njeriut e Stokholm është miratuar më :

- A) 1980;
- B) 1985;
- C) 1972;
- D) 1975.

Pyetja 79

Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut e vitit 1993 është zhvilluar në:

- A) Vjenë;
- B) Romë;
- C) Madrid;
- D) Athinë.

Pyetja 80

Gjirokastra është pranuar në UNESCO më:

